



Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti:	Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
Programi studimor:	Agrobiznes
Titulli i lëndës:	Mbrojtja e bimëve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore (Z)
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Do të shpallet me kohë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Fadil Musa
Detajet kontaktuese:	fadil.musa@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Ky kurs është i dizajnuar që studentëve tu ofroj njohuri teorike dhe praktike lidhur me dëmtuesit dhe sëmundjet e kulturave bujqësore. Gjatë këtij kursi studentët do të njoftohen me morfologjinë e insekteve: koka, antenat, aparati gojor, kraharori, krahët, këmbët, barku dhe shtojcat në të. Integumentin, Sistemin muskulator, zgavrën e trupit, sistemin digjestiv, sistemin respirator, sistemin e qarkullimit të gjakut, sistemin nervor, organet ndijore (për pamje, dëgjim, prekje, nuhatje, shije), organet e riprodhimit. Shumimin dhe zhvillimin e insekteve. Zhvillimin embrional dhe pasembrional. Insektet me zhvillim jo të plotë (Hemimetabola), Insektet me zhvillim të plotë (Holometabola). Larva. Nimfa. Imago. Dimorfizmi dhe polimorfizmi. Diapauza. Ciklin biologjik të insekteve. Klasifikimin e insekteve. Njohjen me përfaqësuesit e grupeve (gjinive, familjeve, rendeve). Insektet pa krahë-<i>Apterygota</i> (Protura, Diplura, Collembola, Thysanura). Insektet me krahë-<i>Pterygota</i> (Orthoptera, Blattodea, Mantodea, Isoptera, Dermaptera, Thysanoptera, Heteroptera, Homoptera, Coleoptera, Lepidoptera, Diptera, dhe Hymenoptera). Faktorët ekologjik, rëndësia dhe klasifikimi i tyre. Faktorë abiotik (temperatura, lagështia, drita, lëvizjet e ajrit, toka). Faktorët biotik (ushqimi, bakteret, kërpudhat, njeriu dhe grabitqarët). Arachnida (merimangat). Myriapoda (qindkëmbëshat). Gastropoda (kërmijtë). Nematoda (nematodet). Mammalia (gjitarët). Parimet e fitopatologjisë. kërpudhat, bakteret dhe viruset si shkaktarët të sëmundjeve të kulturave bujqësore. Përhapja dhe zhvillimi i patogjenëve bimorë. Fazat e zhvillimit të sëmundjes. Ndikimi i faktorëve ekologjikë në patogjenezë. Epifitotilogjia dhe Patofiziologjia. Efektet e patogjenëve në funksionet fiziologjike. Dëmtuesit dhe patogjenët polifag. Dëmtuesit dhe sëmundjet e kulturave lavërtare dhe të perimeve. Dëmtuesit dhe sëmundjet</p>



	e prodhimeve bujqësore në depo. Dëmtuesit dhe sëmundjet e pemëve dhe hardhisë së rrushit. Masat për mbrojtjen e bimëve. Forma e prodhimit dhe mënyra e përdorimit të preparateve kimike. Klasifikimi i mjeteve kimike për mbrojtjen e bimëve. Insekticidet. Akaricidet. Nematocidet. Rodenticidet. Limacidet. Masat e përkujdesit dhe mjetet mbrojtëse gjatë punës.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i modulit është ofrimi i njohurive teorike, praktike dhe shkencore për insektet dhe patogjenët të cilët prekin kulturat bujqësore. Të shpjegohet taksonomia, morfologjia dhe biologjia e insekteve. Dëmtuesit kryesor në kulturat e ndryshme bujqësore dhe dëmet e shkaktuara. Masat kryesore për menaxhimin e agjentëve të dëmshëm biologjik. Ofrimi i njohurive për Mikologjinë. Për sistematikën dhe nomenklaturën e kërpudhave. Konceptet e rëndësishme paraqitën me ndihmën e shembujve nga problemet ekzistuese nga sëmundjet kryesore. Shumëzimi i kërpudhave. Fiziologjia dhe ekologjia e kërpudhave. Sëmundjet kryesore të kulturave të ndryshme bujqësore të cilat kultivohen në vendin tonë dhe masat për menaxhimin e tyre.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Njohin elementet bazë lidhur me dëmtuesit dhe patogjenët shkaktarë të sëmundjeve të kulturat bujqësore. • Kuptojnë mënyrat e shfaqjes, përhapjes dhe shumimit të dëmtuesve dhe patogjenëve shkaktarë të sëmundjeve të kulturat bujqësore. • Analizojnë simptomat e shfaqjes së dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe mënyrat e dimërimit të dëmtuesve dhe patogjenëve. • Njohurit e fituara nga kursi i mbrojtjes së bimëve ti zbatojnë në praktikë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	3	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	1	3	3
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	13	13



Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	8	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
Totali			150(6ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:			
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Kjo është një lëndë me ligjërata dhe ushtrime në të cilin temat prezantohen nga Profesori dhe pjesët praktike, aktivitetet laboratorike dhe ekskursionet shpjegohen nga Profesori dhe Asistenti i lëndës. Në përgjithësi, prezantimet në Power Point janë të disponueshme për studentët në bazën e të dhënave të Fakultetit që profesori i dorëzon një ditë pas secilës ligjëratë të vetme. Materiali shtesë do të sigurohet nga Profesori. Pjesëmarrja në ligjërata inkurajohet fuqimisht.</p> <p>Verifikimi i njohurive do të bëhet pas përfundimit të cikleve të të nxënit. Pas përfundimit të ligjëratave ekziston një pjesë e detyrueshme e testimit përmes kolokviumit dhe provimit përfundimtar me gojë.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv.</p> <p>Vlerësimi i parë: 30 % Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Totali 100%</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pireva, I. (1996): Entomologjia e Përgjithshme. Universiteti i Prishtinës. Fakulteti i Bujqësisë Prishtinë. 2. Susuri, L. & Myrta, A. (2012): Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë së rrushit. Prishtinë. 3. Myrta, A. (2013): Bazat e Virusologjisë Bimore. ADDA Editore. Itali. 4. Susuri, L. (2004): Fitopatologjia. Prishtinë. 5. Alford, D. (1999): A Textbook of Agricultural Entomology. Ministry of Agriculture, Fisheries and Food, Cambridge, UK. 		



Literatura shtesë:	<p>1. Capinera, L. (2001): Handbook of vegetable pest. Academic Pres. Harcourt Place, 32 Jamestown Road, London. UK.</p> <p>2. Raspudić Emilija, Jurković Draženka, Vrandečić Karolina, Štefanić Edita, Šamota D., Baličević Renata, Rozman Vlatka, Liška Anita, Ranogajec Ljubica (2009): Najznačajniji štetnici, bolesti i korovi u uzgoju povrća. Poljoprivredni Fakultet u Osijeku. Osijek. Croatia.</p>
---------------------------	--

Plani i dizajnuar i mësimi		
Java	Ligjërata	Ushtrimet
Java e parë:	Karakteristikat themelore të ndërtimit të insekteve. Morfologjia e Insekteve.	Morfologjia e insekteve (koka, kraharori, abdomeni, aparati gojor, antenat, këmbët)
Java e dytë:	Anatomia dhe fiziologjia e insekteve.	Anatomia e insekteve (sistemi nervor, sistemi i qarkullimit të gjakut, sistemi i frymëmarrjes, sistemi i tretjes)
Java e tretë:	Biologjia dhe shumëzimi i insekteve.	Biologjia e insekteve (organet e riprodhimit, mënyrat e shumimit).
Java e katërt:	Ekologjia e insekteve. Niveli dhe Dinamika e populacioneve	Zhvillimi embrional (embriogjeneza), Zhvillimi pasembrional (larva, nimfa, imago). Metamorfoza e insekteve (Heterometabola dhe Holometabola)
Java e pestë:	Sistematika e insekteve.	Sistematika e insekteve
Java e gjashtë:	Dëmtuesit e kulturave lavërtare dhe perimore.	Insektet me zhvillim jo te plotë (<i>Orthoptera</i> , <i>Heteroptera</i> , <i>Homoptera</i> dhe <i>Thysanoptera</i>)
Java e shtatë:	Dëmtuesit e pemëve dhe hardhisë së rrushit.	Insektet me zhvillim të plotë (<i>Lepidoptera</i> , <i>Coleoptera</i> , <i>Hymenoptera</i> dhe <i>Diptera</i>)
Java e tetë:	Historiku, Zhvillimi, Koncepti dhe Klasifikimi i sëmundjeve te kulturat bujqësore.	Trekëndëshi i sëmundjeve, patogjeneza dhe fazat e zhvillimit të sëmundjeve.
Java e nëntë:	Taksonomia e kërpudhave, baktereve dhe viruseve fitopatogjeve.	Kërpudhat, struktura, ndërtimi dhe shumimi i tyre.
Java e dhjetë:	Tiparet biologjike të kërpudhave, baktereve dhe viruseve.	Sistematika e kërpudhave (Oomycetes, Zygomycetes, Ascomycetes, Basidiomycetes dhe Deutero mycetes).
Java e njëmbëdhjetë:	Fazat e zhvillimit të sëmundjeve dhe ndikimi i	Bakteret, struktura, ndërtimi, shumimi dhe klasifikimi i tyre.



	faktorëve ekologjik në patogjenezë.	
Java e dymbëdhjetë:	Sëmundjet e shkaktuara nga kërpudhat te kulturat lavërtare dhe perimore.	Viruse, struktura, ndërtimi dhe shumimi i tyre
Java e trembëdhjetë:	Sëmundjet e shkaktuara nga kërpudhat te kulturat pentare dhe hardhia e rrushit.	Përgatitja e bazave ushqyese për izolimin e patogjenëve (kërpudhave dhe baktereve) dhe identifikimi i tyre.
Java e katërbëdhjetë:	Sëmundjet e shkaktuara nga bakteret, viruset dhe patogjenët e tjerë te kulturat bujqësore. Masat për luftimin e dëmtuesve dhe patogjenëve të kulturave bujqësore.	Masat e luftimit të dëmtuesve dhe patogjenëve që prekin kulturat bujqësore.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi me test	Kolokviumi me shkrim (pjesa e ushtrimeve)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjëratave, të marrin pjesë në vizita studimore në terren (ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.